



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 42 të Rregullores (QRK) nr. 22/2020, për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN DHE INTEGRIMIN E
QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE TË HUAJVE NË
KOMUNËN E PRISHTINËS 2023-2025

Neni 1

Miratohet Vendimi për Planin komunal për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Prishtinës, 2023-2025.

Neni 2

Plani komunal, i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është bazuar në Strategjinë nacionale dhe Planin e veprimit për zbatimin e strategjisë për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huajve, dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimet për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Prishtinës.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani komunal për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Prishtinës, 2023-2025.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe organet kompetente të administratës komunale.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-561/02-86535/23, më 02.05.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

